

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8001  
E enjte, 27 shkurt 2025  
Çmimi 0.50 €

KMDLNj thërret  
qytetarët ta kundërshtojnë  
shtrenjtimin e energjisë  
elektrike | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

## KURTI: QYTETARËT PRESIN NGA LV-ja T'I FORMOJË INSTITUCIONET | FAQE 4-5



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, se kanë hyrë në fazën finale të procesit të numërimit të votave për zgjedhjet e 9 shkurtit. Ai ka

thënë se Lëvizjes Vetëvendosje i takon t'i formojë institucionet në legjislaturën e nëntë. E anëtarja e kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, shprehu rezervën për një koalicion më të

gjerë që do ta përfshinte edhe procesin e zgjedhjes së presidentit. Ajo ka thënë se ky proces zhvillohet vitin e ardhshëm dhe se tani fokusi është vetëm te formimi i qeverisë

### AKTUALE

MILLORAD DODIKU DËNOHET ME NJË VIT BURGIM DHE GJASHTË VJET NDALESË TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË PRESIDENTIT | F.2

QEVERIA MERR VENDIM PËR RISHIKIMIN AFATMESËM TË STRATEGJISË PËR SUNDIMIN E LIGJIT 2025-2026 | F.3

HAXHIU E KONSIDERON POLITIKE KËRKESËN E PROKURORISË PËR DËSHMINË E KURTIT | F.6

### EKONOMI

RRITJA E ÇMITIT TË ENERGJISË, PAPËRGJEGJËSI NGA ANA E QEVERISË SË KOSOVËS | F.8

Shkruan:  
Ferat SHALA



### "CALIT" I MBETET NË FUQI DËNIMI ME BURGIM PREJ 15 VJETËSH NGA SPECIALJA | F.2

Paneli i Gjykatës Supreme në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë ka hedhur poshtë kërkesën e ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, për ulje të dënimit prej 15 vjetësh burgim. Kjo gjykatë ka rrëzuar ankesat edhe të avokatëve edhe të Prokurorisë



RAPORTIMET PËR TËRHEQJEN E TRUPAVE AMERIKANE NË KOSOVË, "OCTOPUS" E QUAN PËRGËNJESHTRIM I NJË FRIKE TË INSKENUAR | F.4



POSTA E KOSOVËS DHE HELLENIC BEVERAGE COMPANY ZGJEROJNË PARTNERITETIN NË SHËRBIMET POSTARE | F.8

### SPORT



LLAPI DHE DRENICA KUALIFIKOHEN NË GJYSMËFINALE, SOT ZHVILLOHEN DY NDESHJET E TJERA | F.10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## ShBA do të shesë “viza të arta” në vlerë të 5 milionë dollarëve

WASHINGTON, 26 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se planifikon shitjen e lejeve të ‘arta’ të qëndrimit për pesë milionë dollarë, dhe se oligarkët rusë nuk do të përjashtohen nga skema. Trumpi e ka paraqitur programin në Shtëpinë e Bardhë, duke thënë se blerja e këtij dokumenti do të nisë brenda dy javësh. “Kemi leje të gjelbër [green card], kjo është e artë. Do t’ia vendosim çmim rreth 5 milionë dollarë”, ka thënë Trumpi, duke shtuar se të hyrat nga shitjet do të përdoren për ta ulur deficitin. Programi do të jetë për “njerëzit e pasur” që mund të hapin vende pune, ka thënë presidenti. “Për njerëzit e

pasur dhe të suksesshëm, ata që do të shpenzojnë shumë para dhe do të paguajnë taksa dhe do të punësojnë shumë njerëz, dhe mendoj që do të jemi jashtëzakonisht të suksesshëm”, ka thënë Trumpi. Personat që do të aplikojnë për këtë lloj të lejes së qëndrimit do të analizohen në hollësi. “I di disa oligarkë rusë që janë njerëz të mirë. Është e mundshme”, ka thënë Trumpi, duke shtuar se: “Ata nuk janë të pasur siç kanë qenë dikur, por mendoj që mund t’i përballojnë pesë milionë dollarë”. Sekretari amerikan i Tregtisë, Howard Lutnick, u ka thënë gazetarëve se “Viza e artë Trump” do ta zëvendësojë



programin e imigrimit EB-5, i cili është krijuar nga Kongresi më 1990 për të gjeneruar investime të huaja.

Vizat EB-5 janë të disponueshme për personat që shpenzojnë rreth 1 milion dollarë në një kompani dhe që

punësojnë të paktën 10 persona. Lutnick ka thënë se viza e re do ta rrisë çmimin në 5 milionë dhe do ta shmangë mashtrimin e bërë me programin EB-5. Një hulumtim i publikuar nga Kongresi më 2023 pati treguar se shumë vëzhgues kanë shqetësime për mashtrimet e kryera me programin EB-5. Ata kanë thënë se lëshimet bëhen kur aplikuesit nuk raportojnë si duhet të ardhurat, identitetin, apo nuk arrijnë të bëjnë investime. Më shumë se gjysma e vizave EB-5 më 2022 u janë ndarë shtetasve të Kinës. Trumpi ka vlerësuar se ShBA-ja do të mund të shesë rreth një milion viza të arta.

## Millorad Dodiku dënohet me një vit burgim dhe gjashtë vjet ndalesë të ushtrimit të detyrës së presidentit

SARAJEVË, 26 SHKURT - Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës në Sarajevë e ka dënuar presidentin e Republikës Sërpska, Millorad Dodik me një vit burgim dhe gjashtë vjet ndalesë të ushtrimit të detyrës së presidentit për mosrespektimin e vendimeve të Përfaqësuesit të Lartë të bashkësisë ndërkombëtare, Christian Schmidt. Pas marrjes së vendimit, Dodiku u ka thënë mbështetësve të tubuar para Asamblesë Kombëtare të Republikës Sërpska në Banjallukë, se “nuk ka arsye për shqetësim”. “Më dënuan me një vit në burgun e tyre. Thonë se jam fajtor. Nuk ka asnjë arsye për shqetësim. Unë jam mësuar të përballem edhe me gjëra më të vështira, prandaj do ta

përballojmë edhe këtë”, ka thënë Dodiku. Ky është dënimi i shkallës së parë ndaj të cilit Dodiku ka mundësi të ankohet. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Gazetës Zyrtare të këtij entiteti, Millosh Llukiq, është liruar nga të gjitha akuzat. Në pritje të vendimit për Dodikun, në Banjallukë është mbajtur një protestë në shenjë mbështetjeje të tij. Dodiku akuzohet për nënshkrimin e dekreteve presidenciale me të cilat shpalli të vlefshme dy ligje jokushtetuese të Republikës Sërpska, të cilat më parë ishin shfuqizuar nga Përfaqësuesi i Lartë. Bëhet fjalë për Ligjin mbi moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë-Hercegovinës, dhe moszbatimin e vendimeve të Përfaqësuesit të Lartë në



territorin e Republikës Sërpska. Llukiqi akuzohej për publikimin e këtyre ligjeve dhe dekreteve në Gazetën Zyrtare të Republikës Sërpska. Kodi Penal i Bosnjë-Hercegovinës për mosrespektimin e vendimeve të Përfaqësuesit të Lartë, parashikon dënim me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet, si dhe mundësinë e shkarkimit nga detyra të një individi dhe ndalimin e

veprimtarisë politike. Në fjalën përfundimtare, më 19 shkurt, Prokuroria e Bosnjës kërkoi nga Gjykata të shqiptojë një dënim me pesë vjet burgim për Dodikun dhe t’i ndalojë veprimtarinë politike për dhjetë vjet. Po të njëjtin dënim maksimal prokurorët e kërkuan edhe për Llukiqin. Dodiku, në fjalën e tij përfundimtare, tha se “të gjithë bashkë duhet të luftojmë që Bosnjë-Hercegovina të mos jetë më një protektorat, por ta rikthejë sovranitetin e saj”, duke përsëritur pretendimet e vjetra se Schmidt nuk ka legjitimitet, pasi emërimi i tij nuk është konfirmuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, siç ka ndodhur me përfaqësuesit e mëparshëm të lartë. Gjyqi ndaj Dodikut dhe Llukiqit filloi më 5 shkurt 2024

dhe është shoqëruar me akuzë nga mbrojtja ndaj Gjykatës së Bosnjës, gjyqtarëve dhe prokurorëve për anshmëri, si dhe kërkesa për zhvendosjen e procesit gjyqësor në një gjykatë në Banjallukë. Çdo seancë është ndjekur nga dhjetëra mbështetës të Dodikut nga e gjithë Bosnja, të cilët pretendonin se kishin ardhur me vullnetin e tyre përpara ndërtesës së gjykatës në Sarajevë. Udhëheqësia e Republikës Sërpska ka kërcënuar me “vendime radikale” dhe braktisjen e të gjitha institucioneve të Bosnjë-Hercegovinës nëse Dodiku dënohet. Edhe një ditë para shpalljes së aktgjyqimit, në Banjallukë u mbajt një tubim mbështetës për institucionet e Republikës Sërpska.

## Forcat speciale hungareze kryejnë stërvitje me Policinë e Republikës Sërpska

BUDAPEST, 26 SHKURT - Zyrtarët policorë të Qendrës për Luftën kundër Terrorizmit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Hungarisë dhe pjesëtarët e Njësisë Speciale kundër Terrorizmit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) të Republikës Sërpska po realizojnë të mërkurën stërvitje dhe trajnim, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të këtij entiteti serb të Bosnjë-Hercegovinës. Në njoftim është bërë me dije se qëllimi i bashkëpunimit është avancimi dhe përmirësimi i

aftësive të zyrtarëve policorë që kryejnë detyra dhe operacione të ndërlikuara të sigurisë, dhe se ushtrimet janë të fokusuara në luftën kundër terrorizmit. Mes të tjerash, përmendet se ushtrimet po zhvillohen në kuadër të Qendrës së Trajnimit pranë Banjallukës, dhe se njëria nga Hungaria ndodhet në vizitë zyrtare në këtë rajon të Bosnjës. Drejtori i Policisë së Republikës Sërpska, Sinisha Kostresheviq, dhe drejtori i Qendrës për Luftën Kundër Terrorizmit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Hungarisë,



Janosh Hajdu, nënshkruan të martën në Banjallukë një memorandum mirëkuptimi për forcimin e bashkëpunimit policor midis Ministrisë së

Punëve të Brendshme të Republikës Sërpska dhe Qendrës për Luftën Kundër Terrorizmit të MPB-së së Hungarisë me qëllim

parandalimin dhe zbulimin e veprave penale të terrorizmit. Bashkëpunimi përfshin luftën kundër terrorizmit, shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira, bashkëpunimin teknik dhe shkencor, si dhe bashkëpunimin në fushën e trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta për pjesëtarët që kryejnë detyra të ndërlikuara të sigurisë. Këto aktivitete është thënë se do të vazhdojnë në ditët në vijim në disa lokacione në Republikën Sërpska.



# “CALIT” I MBETET NË FUQI DËNIMI ME BURGIM PREJ 15 VJETËSH NGA SPECIALJA

Paneli i Gjykatës Supreme në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë ka hedhur poshtë kërkesën e ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, për ulje të dënimit prej 15 vjetësh burgim. Kjo gjykatë ka rrëzuar ankesat edhe të avokatëve edhe të Prokurorisë

**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

HAGË, 26 SHKURT - Paneli i Gjykatës Supreme në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë ka hedhur poshtë kërkesën e ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, për ulje të dënimit prej 15 vjetësh burgim. Ky panel, i përbërë nga kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova dhe gjykatësit Christine van den Wyngaert dhe Daniel Fransen, ka hedhur poshtë edhe ankesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për vendimin e vitit të kaluar të Apelit. “Paneli konstatoi se Mustafa nuk arriti të identifikojë se si dënimi prej 15 vitesh përbën shkelje të ligjit penal”, thuhet në vendimin e publikuar.

Fillimisht në dhjetor të vitit 2022 Mustafa ishte dënuar për krime lufte me 26 vjet burgim për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. Në dhjetor të vitit 2023 Apeli ia kishte ulur dënimin në 22 vjet burgim. Por, më vonë, më 10 shtator 2024, u tha se Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi ndaj Mustafës dënim të njëzuar prej 15 vjetësh burgim “duke llogaritur dhe kohën në paraburgim”. “Vendimi ka ndjekur udhëzimet e vendimit të Panelit të Gjykatës Supreme të datës 29 korrik 2024, lidhur me kërkesën e zotit Mustafa për mbrojtjen e ligjshmërisë, i cili anuloi dënimin e zotit Mustafa me 22 vjet burgim dhe ia ktheu çështjen përsëri Panelit të Apelit”, u tha në njoftim. Mustafa është arrestuar dhe më pas është transferuar në



njësinë e paraburgimit të Dhomave të Specializuara më 24 shtator të vitit 2020. Procesi gjyqësor kishte nisur më 15 shtator të vitit 2021 dhe në të kanë marrë pjesë 29 dëshmitarë - 14 të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe 15 të mbrojtjes. Gjatë gjyqësorit edhe tetë viktimat kanë dhënë dëshmitë e tyre. Mustafa është personi i parë që është dënuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, që njihen edhe si Gjykata Speciale lidhur me

akuzat që kanë të bëjnë me krime lufte. Në korrik të këtij viti Gjykata ka dënuar edhe Pjetër Shalën me 18 vjet burgim për krime lufte. Përveç Mustafës dhe Shalës, të akuzuar për krime lufte janë edhe ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep Selimi, dhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup

Krasniqi. Gjyqi ndaj tyre është duke vazhduar, ndërsa së fundi është thënë se dëshmitarët e fundit të ftuar nga prokurorët do të dëshmojnë deri më 4 prill. Më herët nga Dhomat e Specializuara në Hagë janë dënuar ish-krerët e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, për pengim të administrimit të drejtësisë, por më pas janë liruar me kusht.

## QEVERIA MERR VENDIM PËR RISHIKIMIN AFATMESËM TË STRATEGJISË PËR SUNDIMIN E LIGJIT 2025-2026

**EPOKA ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 26 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës në të cilën ka aprovuar disa rregullore, udhëzime dhe ka miratuar disa vendime. Kabineti qeveritar ka aprovuar Rregulloren për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore. Luftimi i dhunës në familje, dhunës në bazë gjimore dhe dhunës ndaj grave është një nga objektivat kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kjo rregullore specifikon në mënyrë të qartë rolin dhe përgjegjësinë e nivelit lokal në gjithë këtë betejë. Po ashtu, ka aprovuar Udhëzimin Administrativ për linjën Telefonike Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Baza Gjimore. Viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhuna me bazë gjimore kanë nevojë për reagim të shpejtë dhe



efikas të institucioneve të shtetit. Linja telefonike emergjente ofron ndihmë të menjëhershme në situata emergjente dhe referim të shpejtë të shërbimit përkatës, duke siguruar që viktimat të kenë qasje në shërbimet e nevojshme për

mbrojtjen dhe fuqizimin e tyre. Gjithashtu, ka aprovuar Udhëzimin Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin dhe Funkcionimin e Organizatave Joqeveritare. Përmes ndryshimeve të parapara në

këtë udhëzim janë rregulluar afatet e ankesave kundër secilit vendim përfundimtar nga departamenti për OJQ, si dhe është harmonizuar edhe afati për shqyrtimin e kërkesave. Kabineti qeveritar ka ndarë mjete financiare në mbështetje

të Orkestrës së Fëmijëve “Amadeus” për pjesëmarrje në garat botërore të orkestrave në Vjenë “World Orchestra Festival Viena 2025”. Me këtë mbështetje ndaj orkestrës së vetme të fëmijëve që është vazhdimisht aktive dhe me program të gjerë, do të arrihet që nëpërmjet këtij përfaqësimi në Vjenë të Austrisë në mesin e pjesëmarrësve nga shumë vende të botës, të promovohen vendi dhe kultura jonë nëpërmjet brezave të rinj. Po në këtë mbledhje është miratuar Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025-2027. Programi parashih veprime dhe aktivitete për një Kosovë më të zhvilluar, me rajone të qëndrueshme dhe të afta për konkurrencë. Ai përcakton masat, aktivitetet për arritjen e objektivave, sipas prioritetëve për zhvillim rajonal të balancuar, burimet financiare dhe autoritetet përgjegjëse. Kabineti qeveritar ka miratuar edhe vendimin për rishikimin afatmesëm të Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe Planit të Veprimit 2025-2026.





## KURTI: QYTETARËT PRESIN NGA LV-ja T'I FORMOJË INSTITUCIONET

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, se kanë hyrë në fazën finale të procesit të numërimit të votave për zgjedhjet e 9 shkurtit. Ai ka thënë se Lëvizjes Vetëvendosje i takon t'i formojë institucionet në legjislaturën e nëntë. E anëtarja e kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, shprehu rezerva për një koalicion më të gjerë që do ta përfshinte edhe procesin e zgjedhjes së presidentit. Ajo ka thënë se ky proces zhvillohet vitin e ardhshëm dhe se tani fokusi është vetëm te formimi i qeverisë

**EPOKA E RE** Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, se Lëvizjes Vetëvendosje i takon t'i formojë institucionet në legjislaturën e nëntë. "Kemi hyrë në fazën finale të procesit të numërimit të votave për zgjedhjet e 9 shkurtit. Sot fillon numërimi i votave të diasporës. Sipas njoftimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor, më së largu deri në javën tjetër pritet të kemi rezultatet përfundimtare për subjektet politike. Si fitues të qartë të këtyre zgjedhjeve, nga ne qytetarët presin që sa më parë ta përmbushim obligimin që na takon për formimin e institucioneve në legjislaturën e 9. Deri atëherë

nga ju, të nderuar kabinet qeveritar, kolegë, pres që ta vazhdoni punën dhe punët e mira me po të njëjtin ritëm", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se të gjithë presin nga Komisioni Qendror Zgjedhor edhe më shumë angazhim për përfundimin e procesit të numërimit dhe kujdes të shtuar në mbrojtjen e vullnetit të votuesve për të përmbyllur kësajsoj një proces zgjedhor të lirë, të rregullt, të ndershëm e demokratik, me pjesëmarrje masive të qytetarëve. "Pjesëmarrje më të lartë ndonjëherë në zgjedhje pati edhe diaspora jonë, e cila për herë të parë, përveç votimit me postë, pati mundësinë të votojë edhe në ambasada dhe konsullatat tona. Falënderoj bashkatdhetarët që morën pjesë në këto zgjedhje, qoftë përmes votimit nga jashtë,

qoftë duke udhëtuar në Kosovë për të votuar, duke u bërë ashtu edhe siç janë pjesë e pandashme e vendimmarrjes për vendin tonë", ka thënë Kurti.

Sipas rezultateve preliminare, Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka dalë e para në këto zgjedhje me 40.90 për qind të votave. Ndonëse ende nuk janë numëruar votat me kusht, ato të personave me nevoja të veçanta dhe votat e diasporës, kjo parti nuk e ka siguruar shumicën e nevojshme për formim të qeverisë.

E dyta ka dalë Partia Demokratike e Kosovës me 22.05 për qind. E treta ka dalë Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.64 për qind të votave, pasuar nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.46 për qind të votave të fituara. Nga partitë

e komunitetit serb, më së shumti vota ka marrë Lista Serbe, përkatësisht 4.62 për qind.

Analistët politikë kanë përmendur mundësinë e bashkimit të forcave të LV-së me komunitetet joserbe, që i kanë 10 ulëse të garantuara në Kuvend.

Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë hedhur poshtë mundësinë e krijimit të koalicionit me LV-në dhe kanë shprehur gatishmëri për formimin e një qeverie së bashku.

Për formimin e institucioneve të reja ka folur edhe anëtarja e kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu. Ajo ka thënë se votat nga diaspora do të jenë përcaktuese për formimin e qeverisë pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. Ajo u shpreh e vendosur se Lëvizja Vetëvendosje do ta formojë qeverinë, derisa tha se partnerët e koalicionit tashmë janë Guxo dhe Alternativa.

Numërimi i votave nga diaspora dhe atyre me kusht kanë filluar të numërohen të mërkurën në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve nga KQZ-ja. "Ne jemi fitues i

qartë i këtyre zgjedhjeve. Lëvizja Vetëvendosje është fituese e qartë e këtyre zgjedhjeve. Neve na takon obligimi për formimin e institucioneve pas certifikimit të rezultatit zgjedhor. Siç e dini, Lëvizja Vetëvendosje i ka partnerët e koalicionit të cilët janë Guxo dhe Alternativa. Ne duhet të presim edhe pak... Votat e diasporës janë shumë të rëndësishme dhe janë përcaktuese që qeveria jonë të formohet dhe të drejtohet nga kryeministri Kurti. Uroj që ky proces mos të zgjasë më tepër", ka thënë Haxhiu.

Haxhiu, e cila është edhe ministre në detyrë e Drejtësisë, në konferencën për medie pas mbledhjes së qeverisë u shpreh më e rezervuar për një koalicion më të gjerë që do ta përfshinte edhe procesin e zgjedhjes së presidentit. Ajo tha se ky proces zhvillohet vitin e ardhshëm dhe se tani fokusi është vetëm te formimi i qeverisë. "Sa i përket zgjedhjes së presidentit, shkove larg pasi si proces do të zhvillohet vitin e ardhshëm. Prandaj le të fokusohemi njëherë te qeveria", ka theksuar Haxhiu.



# RAPORTIMET PËR TËRHEQJEN E TRUPAVE AMERIKANE NË KOSOVË, “OCTOPUS” E QUAN PËRGËNJESHTRIM I NJË FRIKE TË INSKENUAR



PRISHTINË, 26 SHKURT - Zhvillimet e fundit gjeopolitike, veçanërisht sa i përket luftës në Ukrainë dhe përpjekjeve të vazhdueshme diplomatike, kanë nxitur diskutime në rajone të ndryshme. Një artikull i fundit i publikuar nga gazeta gjermane “Bild”, me titullin “Evropa në frikë. Agjencitë e Inteligjencës druhen nga tërheqja e trupave amerikane”, ka ndezur përsëri narrativat armiqësore pro-ruse, veçanërisht pas negociatave të nisura në Riad. Instituti për Studime të Luftës Hibride “Octopus” në një analizë të publikuar me autorë Arben Fetoshi dhe Gurakuq Kuçi ka theksuar se portretizimi i ridislokimit të burimeve ushtarake amerikane si një “tërheqje” është një raport i njëanshëm, i synuar për të përhapur frikë dhe shqetësim në publik. “Pavarësisht nëse motivi i medias është i drejtuar nga një agjendë politike apo një prirje ndaj sensacionalizmit, interpretimi i paralajmërimit të presidentit Trump se ai do ta ulte numrin e trupave me rreth 20 000 - për shkak të barrës financiare që nuk duhet të përballohet vetëm nga taksapaguesit amerikanë - duke i nxitur vendet evropiane t’i rrisin shpenzimet e tyre për mbrojtjen, është një interpretim i gabuar dhe i pabazuar. Presidenti i Polonisë, Andrzej Duda, pas një takimi në Varshavë më 19

shkurt me Keith Kellogg, i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ukrainën dhe Rusinë, mohoi kategorikisht thashethemet për një reduktim të trupave amerikane në këtë pjesë të Evropës. Deklarata e presidentit Duda bie drejtpërdrejt ndesh me raportin e “Bild”, i cili citonte një zyrtar të lartë të sigurisë në Evropën Lindore që pretendonte se trupat amerikane po tërhiqeshin bazuar në kërkesën e Rusisë të vitit 2021 që NATO të largohej nga Evropa Lindore”, thuhet në këtë analizë. Theksohet se për më tepër nga takimi Trump-Macron në Shtëpinë e Bardhë nuk dolën asnjë tregues për një tërheqje të trupave amerikane nga kontinenti evropian. “Diskutimet e samitit u përqendruan në arritjen e një armëpushimi në Ukrainë, mundësinë e vendosjes së forcave paqeruajtëse evropiane dhe marrëveshjet ekonomike lidhur me mineralet kritike të Ukrainës. Të dy liderët theksuan nevojën që Evropa t’i forcojë kontributet e saj në mbrojtje, ndërsa presidenti Trump deklaroi se edhe Putini pajtohet me vendosjen e trupave paqeruajtëse në Ukrainë. Aktualisht ShBA mban rreth 65 000 trupa të përhershme në Evropë, me forca rotative shtesë që e çojnë totalin në rreth 100 000 ushtarë”, thuhet në analizë.

## Stabiliteti rajonal dhe interesat gjeostrategjike

“Octopus” në këtë analizë thekson se artikulli i “Bild”-it u citua nga disa media ndërkombëtare, por pati jehonën më të madhe në Ballkanin Perëndimor për shkak të implikimeve të tij për Kosovën. “Mediet serbe e vendosën të ashtuquajturën ‘tërheqje’ të trupave amerikane nga Kosova në qendër të raportimeve të tyre, pavarësisht se këto spekulime u adresuan menjëherë nga KFOR-i. Në një deklaratë zyrtare, KFOR-i siguroi se zyrtarët amerikanë e kishin bërë të qartë përkushtimin e tyre ndaj Aleancës Veri-Atlantike. Megjithatë, kjo narrativë e mediave serbe është rikthyer vazhdimisht sa herë që NATO rishikon situatën e sigurisë në Kosovë. Që nga vendosja e mbi 50,000 trupave të NATO-s në vitin 1999, niveli i forcave është reduktuar gradualisht bazuar në vlerësimet e sigurisë, duke arritur aktualisht në 4,686 trupa nga 29 vende. Prania e trupave amerikane brenda KFOR-it ka qenë një faktor vendimtar në ruajtjen e paqes në Kosovë, siç u dëshmuar nga roli i tyre në zbrapsjen e sulmeve të huliganëve serbë në vitin 2023 dhe inkursionit të armatosur në veri të Kosovës në shtator 2024, i cili e detyroi NATO-n të rrisë numrin e trupave. Një tërheqje e mundshme e ShBA-së do të krijonte një vakuum të

pushtetit që ekstremistët serbë mund ta interpretonin si një mundësi për të shtyrë përpara ambicet e tyre territoriale. Në të njëjtën kohë, Serbia, për shkak të lidhjeve të saj të ngushta me Rusinë, mund ta shihte këtë ndryshim si një shans për të zgjeruar ndikimin e saj, duke rritur rrezikun e destabilizimit dhe mundësisë së një konflikti në rajon”, thuhet në analizë. Tutje theksohet se nga ana tjetër, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), e njohur dhe e mbështetur nga ShBA si Ushtria e Kosovës, është në proces transformimi në një forcë të dëshmuar të përkushtuar ndaj vlerave transatlantike, përmes pjesëmarrjes në misione të përbashkëta paqeruajtëse. “Prania ushtarake amerikane në Kosovë përbëhet nga dy kategori: trupa brenda KFOR-it, që operojnë nën strukturën komanduese të NATO-s dhe personel që vepron jashtë kësaj strukture komanduese. Kampi Bondsteel, baza më e madhe amerikane në Ballkan, jo vetëm që strehon trupa të KFOR-it, por gjithashtu përfshin personel të inteligjencës, logjistikës dhe bashkëpunimit të sigurisë, të cilët punojnë ngushtë me institucionet e Kosovës. Roli i ShBA-së në transformimin e FSK-së - i dëshmuar nga aproovimi i blerjes së raketave Javelin dhe, më së fundmi, helikopterëve Black Hawk - nënvizon më tej rëndësinë strategjike të Kosovës. Në këtë kontekst, çdo

tërheqje e mundshme e forcave amerikane nga Kosova do të krijonte një vakuum të pushtetit që mund të shfrytëzohej nga Rusia dhe aktorë të tjerë armiqësorë. Duke pasur parasysh mbështetjen e Rusisë për Serbinë, një tërheqje e ShBA-së do të zhvendoste ekuilibrin rajonal të pushtetit në favor të interesave ruse në Ballkan”, thuhet në analizën e “Octopus”-it. Për më tepër, thuhet se një veprim i tillë do ta minonte besueshmërinë e ShBA-së mes aleatëve evropianë, duke pasur parasysh rolin udhëheqës të Uashingtonit brenda NATO-s. “Siç u pa në rastin e Afganistanit, një tërheqje e parakohshme e forcave nga zonat e konfliktit shpesh rezulton në rishfaqjen e dhunës dhe destabilizimin rajonal. Rëndësia strategjike e Kosovës për ShBA-në vërehet më tej nga ndërtimi i Ambasadës Amerikane në Prishtinë, e cila shtrihet në gati pesë hektarë - duke e bërë atë ambasadën më të madhe amerikane në Ballkan. Prandaj, shqetësimet e ngritura nga artikulli i “Bild” ilustronjë se si informacioni i vjetruar mund të ripërdoret për të ndikuar në perceptimet e reja, në varësi të kontekstit politik. Qoftë qëllimisht apo jo, një informacion i tillë mund të shërbejë si një konstrukt strategjik i destinuar për të ndikuar opinionin publik dhe vendimmarrësit shtetërorë”, përfundon analiza e “Octopus”-it.



## Cakolli: Qeveria aktuale ushtron të gjitha kompetencat kushtetuese deri në certifikimin e rezultateve nga KQZ-ja

PRISHTINË, 26 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pritet që në ditët në vazhdim t'i certifikojë rezultatet e zgjedhjeve të 9 shkurtit. E derisa ende nuk ka certifikim të këtyre rezultateve, Eugen Cakolli nga Instituti

Demokratik i Kosovës ka thënë që qeveria aktuale ushtron të gjitha kompetencat kushtetuese. "Mandati i qeverisë lidhet drejtpërdrejt me mandatin e Kuvendit, i cili përfundon me certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, jo me

përbushjen e katër viteve nga konstituimi i Kuvendit (22 mars). Prandaj, qeveria aktuale ushtron të gjitha kompetencat e saj kushtetuese deri në certifikimin e rezultateve nga KQZ-ja", ka pohuar ai. Cakolli ka theksuar se anëtarët

e kabinetit qeveritar që janë zgjedhur deputetë duhet të japin dorëheqje para certifikimit të rezultateve. "Vetëm atëherë qeveria kalon në statusin e 'qeverisë në detyrë' derisa të zgjidhet qeveria e re", ka shkruar Cakolli.



## HAXHIU E KONSIDERON POLITIKE KËRKESËN E PROKURORISË PËR DËSHMINË E KURTIT

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, ka thënë të mërkurën se veprimet e sistemit të drejtësisë në Kosovë janë krejtësisht politike, dhe ka përsëritur edhe një herë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk e ka refuzuar asnjëherë kërkesën e Prokurorisë Speciale që të japë dëshmi në cilësinë e dëshmitarit në një rast të hapur lidhur me dyshimet për keqpërdorime me rezerva shtetërore.

Javën e kaluar Prokuroria i ka bërë kërkesë Gjykatës Themelore në Prishtinë ta urdhërojë Kurtin të paraqitet, pas refuzimit të dy ftesave të mëparshme. "Nuk e di saktësisht se si Prokuroria Speciale i është referuar Gjykatës për këtë urdher, nuk e kam parë si të tillë. Nëse Prokuroria ka thënë se kryeministri Kurti nuk po pranon ta japë dëshminë, kjo është e pavërtetë, kjo është gënjeshtër, sepse kryeministri Kurti nuk ka refuzuar të japë dëshmi", ka thënë Haxhiu në një konferencë për medie. Sipas saj, kërkesa e vetme e kryeministrit Kurti është lokacioni - që dëshmia të merret prej zyrës së tij. "Prokuroria nuk duket që është



e interesuar për ta marrë dëshminë e kryeministrit Kurti, sepse i ka pasur disa mundësi, disa data që ka propozuar Kurti dhe nuk ka ardhur për ta marrë dëshminë".

Në Kodin e Procedurës Penale thuhet se një gjyqtar, sipas detyrës zyrtare, apo me kërkesë të Prokurorit të Shtetit, mund ta detyrojë një dëshmitar që të paraqitet. E nëse pas urdhit gjyqësor i ftuari nuk paraqitet në Prokurori, gjyqtari e dënon atë me gjobë prej 250 eurosh sa herë që ai refuzon. Por, nëse ka refuzim edhe pas shqiptimit të gjobave, ai mund të burgoset, por jo më shumë se një muaj. Qeveria e Kosovës nuk është

përgjigjur në kërkesën e Radios Evropa e Lirë për koment ndaj kësaj kërkesë të Prokurorisë Speciale. Duke komentuar nenin që përcakton se pas refuzimit të vazhdueshëm të një dëshmitari mund të shqiptohet edhe gjoba, Haxhiu ka thënë se ai "ka të bëjë me personat që refuzojnë të japin dëshmi, me personat që thonë 'nuk dua të japë dëshminë time' në raport me këtë çështje". "Sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës kurrë më i lirë nuk ka qenë nga ndikimi politik. Por, më duhet të them, kurrë më politik nuk ka qenë. Duke qenë se nuk kanë mundur të na ndalin me

veprime në Kuvend, opozita, ose dikush nga analistët në studiot televizive, kanë zgjedhur me Prokurorinë Speciale, por nuk mund të na ndalin", ka deklaruar Haxhiu pa përmendur dikë me emër dhe pa ofruar dëshmi për pretendimet e bëra.

Ftesën e parë Kurti e kishte marrë më 16 dhjetor, kur zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, kishte thënë se Kurti nuk ishte paraqitur pasi që ishte në udhëtim jashtë vendit dhe kishte shtuar se Kurti "ka shprehur gatishmërinë t'i mirëpresë prokurorët e rastit në zyrën e tij në një ditë dhe orë të dakorduar nga të dyja palët për ta përbushur kërkesën e dalë nga ftesa e Prokurorisë".

Katër ditë më vonë Kurti kishte marrë sërish ftesë nga Prokuroria, së cilës prapë nuk i ishte përgjigjur pozitivisht. Ftesa e Kurtit që prokurorët ta intervistojnë atë në zyrën e tij është kritikuar nga ekspertë ligjorë, si Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Viona Bunjaku nga Lëvizja FOL.

Miftaraj kishte thënë se "nëse prokurorët nuk kanë guxim profesional", atëherë jo vetëm kryeministri, por edhe qytetarët e zakonshëm "mund

të tallen dhe të mos e respektojnë autoritetin e Prokurorisë".


Më 2023 tre persona ishin arrestuar për rastin e rezervave shtetërore. Në mesin e tyre ishin edhe punonjës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) që udhëhiqet nga Rozeta Hajdari, e cila gjatë paraqitjes për dëshmi në Prokurorinë Speciale ka zgjedhur të mbrohet në heshtje.

Në këtë ministri më 2023 u kryen bastisje pas publikimit të audio-incizimeve nga portali "Nacionale", ku pretendohet se një sasi vaji, e blerë në Poloni, dhe një sasi gruri, e blerë në Turqi, nuk kishin arritur kurrë. Qeveria ka thënë se pagesat për rezervat shtetërore ishin bërë në përputhje me ligjin. Hajdari tha në atë kohë se blerjet për rezerva shtetërore janë bërë në përputhje me ligjin, por nuk dha më shumë detaje, megjë informacionet për to janë sekrete shtetërore. Ajo e akuzoi policinë se gjatë bastisjeve ka marrë në cilësinë e provave dokumente të klasifikuara si sekrete shtetërore. Kurti i doli në mbrojtje Hajdarit, duke thënë se "nuk ka kurrfarë korrupsioni e keqpërdorimi".

## ÇEKU: PO PRESIM PËR GJIGJEN E OVLUÇK-SË PËR SHËNIMIN E 27-VJETORIT TË EPOPESË SË UÇK-SË

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka deklaruar se janë në pritje të konfirmimit për pjesëmarrjen e Organizatave të Veteranëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) në Këshillin Shtetëror për shënimin e 27-vjetorit të Epopesë së UÇK-së. Ai në konferencën për medie mbajtur pas mbledhjes së qeverisë tha se të enjten është

mbledhja e këshillit. Sipas tij, organizatat e dala nga lufta e kanë vendin aty. "Ne u kemi dërguar ftesë pasi janë në vendim të anëtarëve të këshillit organizativ të tri organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, ndërsa po presim konfirmimin e tyre. Dje kishim një deklaram publik nga njëri prej përfaqësuesve të këtyre organizatave i cili tha se do të bëjnë një konsultim të brendshëm të tri organizatave



dhe do të marrin vendim. Ne i ftojme të jenë pjesë e këtij organizimi pasi aty e kanë

vendin. Epopeja e UÇK-së është e të gjithëve dhe sidomos e atyre që kanë qenë pjesë e luftës. Në këtë drejtim nesër mbledhja duhet të tregojë bashkëpunim dhe unitet", tha ai.

Çeku theksoi se çdo përpjekje për ta politizuar këtë moment të rëndësishëm, në rastin më të mirë duhet të injorohet. "Çdo përpjekje për të politizuar një moment kaq të rëndësishëm

dhe një datë kaq të rëndësishme të historisë, besoj se duhet të injorohet në rastin më të mirë. Unë kam shumë përgjigje për propagandën që është bërë kinse qeveria Kurti është kundër kategorive të dala nga lufta. Të gjitha të dhënat, dëshmitë janë lehtë të qasshme dhe shumë lehtë mund të rrëzohet kjo propagandë që është bërë çdoherë", theksoi ai.

## QMF në lagjen "Kodra e Trimave" bëhet me inventar të ri

PRISHTINË, 26 SHKURT - Qendra e Mjekësisë Familjare në lagjen "Kodra e Trimave" është pajisur me inventar të

ri. Komuna e Prishtinës ka njoftuar se pas renovimit të Qendrave të Mjekësisë Familjare, tashmë ka nisur

inventarizimi i tyre për të siguruar pajisje moderne dhe shërbim më efikas për qytetarët. "Investojmë

vazhdimisht për një kujdes shëndetësor më cilësor!", ka njoftuar komuna e Prishtinës.





## ShSKUK-ja thotë se nuk ka mungesë të tretësirës për infuzion

PRISHTINË, 26 SHKURT - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka reaguar ndaj dezinformatave se nuk ka tretësirë, duke sqaruar se furnizimi me të për infuzion (NaCl 0.9%- 500 ml) ka qenë dhe mbetet i qëndrueshëm në të gjitha klinikat e QKUK-së dhe spitalet e përgjithshme. "Theksojmë se në muajin janar 2025, ShSKUK ka pasur në stok 54 mijë e 610 copë me tretje për infuzion, NaCl 0.9%-500 mililitra, të cilat në

vazhdimësi janë shpërndarë në institucionet që menaxhohen nga ShSKUK, si në QKUK, ashtu edhe në spitalet e përgjithshme. Po ashtu, ka sasi të mjaftueshme me sisteme të infuzioneve dhe kanillave, ampula deksam-etazon dhe diklofenak, e që në vazhdimësi shpërndahen në QKUK dhe 7 spitalet e përgjithshme. Po ashtu, në muajin shkurt jemi furnizuar me 16 mijë e 200 copë tretje për infuzion- NaCl 0.9%- 500

mililitra, asnjë moment në njësitë e ShSKUK nuk ka pasur mungesë të tyre", thuhet në reagimin e ShSKUK-së. Sipas këtij reagimi, kjo gjendje e furnizimit mund të verifikohet në çdo çast në Sektorin për Furnizim me Barna dhe Material Shpenzues në ShSKUK, por edhe në klinikat dhe spitalet e përgjithshme. "Andaj, ShSKUK, apelon tek mediat gazetarët dhe shoqëria civile,

para se të shpërndajnë informata të pa verifikuara, paraprakisht të marrin informacionin zyrtar dhe të verifikojnë gjendjen në Sektorin për furnizim me barna dhe material shpenzues, klinikat e QKUK-së dhe spitalet e përgjithshme. Edhe pse ka në stok, furnizimi i ardhshëm, i planifikuar që vjen së shpejti përfshinë mbi 80 mijë copë tretje për infuzione NaCl 0.9%-500 mililitra. Duhet të theksojmë



se ky furnizim është bërë falë angazhimit dhe planifikimit të mirë nga Sektori për furnizim me barna dhe material shpenzues", thuhet në reagimin e ShSKUK-së.

## BE-ja shpreh shqetësim rreth ndërhyrjes në organizatat e shoqërisë civile në Serbi

PRISHTINË, 26 SHKURT - Bashkimi Evropian është duke i ndjekur me vëmendje dhe shqetësim të madh zhvillimet rreth ndërhyrjeve të autoriteteve në Serbi ndaj disa organizatave të shoqërisë civile. Kështu ka thënë të mërkurën një zëdhënës i Bashkimit Evropian, duke u përgjigjur në pyetjet rreth veprimeve të fundit të Policisë në Serbi e cila ka ndërmarrë operacione në zyrat e disa organizatave të shoqërisë civile. "Shoqëria civile luan një rol vital në zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe pluraliste dhe ajo duhet të veprojë në mënyrë të lirë dhe pa presion. Këto janë vlera të cilat jo vetëm se janë në themel të Bashkimit Evropian, por janë edhe të domosdoshme për të ardhmen e secilit vend kandidat që dëshiron të anëtarësohet në BE", ka thënë ky zëdhënës.

Më 25 shkurt Zyra e Prokurorit të Lartë Publik në Beograd ka njoftuar se ka hapur një rast në lidhje me dyshimet për keqpërdorim të fondeve të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nga disa organizata joqeveritare në Serbi. Prokuroria ka konfirmuar po atë ditë se Policia e Serbisë ka nisur "të mbledhë informata" për punën e katër OJQ-ve: Qendrës për Hulultime, Transparencë dhe Llogaridhënie (CRTA), Iniciativave Qytetare, Qendrës për Politika Praktike, dhe Fondacionit Trag.



CRTA dhe Iniciativat Qytetare kanë konfirmuar se Policia ka bastisur zyrat e tyre në mëngjesin e 25 shkurtit. Aksioni i autoriteteve serbe erdhi pasi presidenti amerikan Donald Trump kufizoi punën e USAID-it, duke urdhëruar një ngrirje 90-ditëshe të shpenzimeve të tij, më 24 janar, para një auditimi të agjencisë, e cila u themelua më 1961, me qëllim koordinimin më të mirë të ndarjes së ndihmave amerikane jashtë vendit. Që prej kthimit të Trumpit në Shtëpinë e Bardhë,

administrata e tij dhe njerëz të afërt me të e kanë quajtur vazhdimisht USAID-in "organizatë kriminale". "Siç kemi thënë edhe në paketën e fundit të zgjerimit, nga Serbia pritet të sigurojë një ambient të përshtatshëm për veprimin e shoqërisë civile. Ne do të vazhdojmë të monitorojmë për së afërmi zhvillimet në Serbi" thuhet në këtë prononcim të zëdhënësit të Komisionit Evropian. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se Serbia do t'i ndihmojë Byrosë Federale

amerikane të Hetimeve (FBI) në hetimet e saj rreth financimit të OJQ-ve serbe nga USAID-i dhe nga Fondacioni Kombëtar për Demokraci (NED). "Pa dyshim se ne do të bashkëpunojmë ngushtë me FBI-në për këtë çështje", ka thënë Vuçiqi për televizionin "Happy", duke shtuar se FBI do të marrë çfarëdo informate që ka nevojë nga Serbia. Pasi presidenti amerikan kufizoi punën e USAID-it, administrata presidenciale amerikane po shqyrton futjen e agjencisë nën ombrellën e

Departamentit të Shtetit, si pjesë e një riorganizimi të madh që do ta shkurtojte numrin e punonjësve. Sipas shifrave të fundit, USAID-i ka rreth 10 000 punonjës, dy e treta e të cilëve punon jashtë ShBA-së. Në vitin fiskal 2023 USAID-i shpërndau ndihma me vlerë prej 43.79 miliardë dollarësh. Pranuesit më të mëdhenj të ndihmave më 2023 ishin Ukraina, Etiopia, Jordania, Republika Demokratike e Kongos, Somalia, Jemeni, Afganistani, Nigeria, Sudani Jugor dhe Siria.

## Dogana në një barnatore në Pejë konfiskon mbi 200 lloje të ndryshme të barnave

PRISHTINË, 26 SHKURT - Njësitët Antikontrabandë të Doganës së Kosovës kanë realizuar një kontroll në një barnatore në Pejë për posedim të barnave të kontrabanduara. Në njoftimin e Doganës së Kosovës thuhet se gjatë kontrollit, në një hapësirë të fshehur brenda objektit, janë gjetur produkte farmaceutike pa banderola,

të cilat dyshohet se janë futur në treg në mënyrë të paligjshme. "Gjatë kontrollit, në një hapësirë të fshehur brenda objektit, janë gjetur produkte farmaceutike pa banderola, të cilat dyshohet se janë futur në treg në mënyrë të paligjshme. Si rezultat i këtij operacioni, janë konfiskuar 207 lloje të ndryshme të barnave, në një

sasi totale prej 738 copë", ka njoftuar Dogana. Dogana e Kosovës ka theksuar se vazhdon të jetë e përkushtuar në luftën kundër kontrabandës dhe në mbrojtjen e shëndetit publik, duke ndërmarrë masa të rrepta ndaj të gjithë atyre që shkelin ligjin dhe vënë në rrezik sigurinë e qytetarëve.





## KMDLNj thërret qytetarët ta kundërshtojnë shtrenjtimin e energjisë elektrike

PRISHTINË, 26 SHKURT - Paralajmërimi i ZRrE-së për kërkesën e operatorëve të energjisë elektrike për rritje të çmimit të energjisë elektrike është përgatitje e konsumatorëve se rryma do të shtrenjtohet mbase më pak se 30 për qind. Sipas Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të

Njeriut (KMDLNj), “ky është kontribut konkret për rritje të varfërisë në Kosovë e që për ndrikull e ka Qeverinë e Kosovës dhe ministrinë përkatëse”. “Qeveria e Kosovës po e luan lojën e ndyrë, në vend se të mbrojtë interesat e qytetarëve, po i mbron interesat e operatorëve të energjisë

elektrike. Këtë nuk e ka bërë para zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 por vetëm pasi ato kanë përfunduar”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se kundërshton çdo rritje të çmimit të energjisë elektrike. “Aq më parë që nuk ka asnjë rrethanë që e arsyeton këtë rritje përveç

interesit të oligarkëve qeveritarë, konsumatorëve të privilegjuar, operatorëve të energjisë elektrike dhe strukturës kriminale të ZRrE-së. KMDLNj thërret qytetarët që fuqishëm të kundërshtojnë shtrenjtimin e energjisë elektrike shkaku se do të prodhojë efekte zinxhirore duke provokuar



rritjen e çmimeve të gjithë artikujve të domosdoshëm për mbijetesë dhe shërbimeve”, theksohet në reagimin e KMDLNj-së.

## Rritja e çmimit të energjisë, papërgjegjësi nga ana e Qeverisë së Kosovës



Shkruan: Ferat SHALA

Kërkesa për rritjen e çmimit të energjisë është pasojë e një planifikimi jo të duhur dhe një qasje joprofesionale ndaj kostove reale të operimit.

Nënvlerësimi i kostove në vitin e kaluar dhe shtyrja e tyre për t'u trajtuar më vonë ka krijuar një barrë financiare që tani

duhet të paguhet nga konsumatorët fundor. Kjo praktikë nuk është e drejtë dhe tregon për një menaxhim të dobët dhe të ndikuar, ku vendimet merren më shumë për arsye politike sesa në interes të konsumatorëve.

Sipas kërkesave të paraqitura nga kompanitë e energjisë, rritja e çmimeve mund të jetë e konsiderueshme. Kjo për faktin se KESCO dhe KEDS kanë kërkuar që të hyrat e lejuara për vitin 2025 të rriten dukshëm (rreth 100 milion), si pasojë e tejkalimeve në vitin e kaluar. Nga informatat publike, operatorët (KOSTT, KEDS dhe KESCO) kanë kërkuar rritje rreth 30%, dhe kjo rritje është e papërbalueshme për

konsumatorin. ZRRE, duhet të jetë e kujdesshme duke treguar transparencë dhe profesionalizëm në vlerësimin e aplikimeve tarifore nga operatorët. Sidoqoftë çdo rritje e energjisë elektrike paraqet ngarkesë për konsumatorët dhe papërgjegjësi nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Fatkeqësisht, jemi para një realiteti ku nga Prilli i këtij viti faturat e konsumatorëve do të pësojnë rritje të theksuar, e cila do të legjitimohet përmes vendimit nga bordi i ZRRE-së. Rritja e çmimeve të energjisë nuk duhet të jetë një zgjidhje e parë, por një masë e fundit pas shterimit të të gjitha mundësive për menaxhim më

efikas dhe mbështetje shtetërore. Për ta parandaluar këtë rritje, nevojiten disa hapa të domosdoshëm, si, transparencë më e madhe, ku Institucionet përgjegjëse dhe kompanitë energjetike duhet të jenë më të hapura me publikun për mënyrën se si llogariten tarifatat. Publiku duhet të ketë qasje në të dhëna të detajuara mbi kostot e furnizimit, importit dhe operimit të sistemit energjetik.

Kosova ka humbur shumë në mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik gjatë këtyre 4 viteve. Refuzimi i projekteve për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike ka ndikuar direkt në varshmërinë e sektorit nga

Importi i energjisë elektrike, dhe si pasojë tani konsumatorët i bartin pasojat në faturat e tyre. Prandaj, rritjen e kapaciteteve të brendshme të prodhimit të energjisë nga burime të qëndrueshme, duke shfrytëzuar burimet alternative si era dhe dielli, janë zgjidhje të domosdoshme.

Në këto rrethana, Qeveria duhet të ndërhyjë për të shmangur një barrë të menjëhershme mbi qytetarët. Ndikimet politike nga vitet e kaluara kanë sjellë sektorin energjetik në një situatë të vështirë, prandaj, kërkohet një qasje shtetërore më strategjike për të siguruar një sistem energjetik që është i qëndrueshëm dhe i përbalueshëm për konsumatorët.

## Bajrami, qeverisë: Kujdes kur flet për eksport dhe zhvillim ekonomik, sepse të dhënat zyrtare ju përgënjeshtrojnë keq

PRISHTINË, 26 SHKURT - Kandidatja për deputete nga LDK-ja, Hykmete Bajrami, ka kritikuar sërish qeverinë Kurti. Sipas Bajramit, qeveria nuk po përmend disa fakte për tregtinë e jashtme. “Tregtia e jashtme e Kosovës - faktet që Qeveria nuk i përmend: deficitit tregtar 2001-2021: 37.74 miliardë euro, deficitit tregtar 2021-2024: 18.947 miliardë euro. Kujdes kur flisni për eksport dhe zhvillim ekonomik, sepse të dhënat zyrtare ju përgënjeshtrojnë keq”, ka shkruar ajo në “Facebook”.

Ndër të tjera, ajo ka shkruar se nuk mund të flitet për suksese në eksport duke heshtur importet. “Nuk mund të flasësh për “suksese në eksport” duke heshtur për importet. Nëse e bën këtë, ose nuk e kupton ekonominë, ose po tenton të

manipulosh qytetarët. Kjo nuk do të kalojë pa përgjigje me fakte”, ka theksuar Bajrami. Ajo ka deklaruar se “sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vendi ynë vazhdon të varet nga importet dhe gjendja është alarmante: Vetëm në një mandat të kësaj qeverie deficitit tregtar ka arritur nivelin e 10 viteve të mëparshme, sepse: Ekonomia nuk zhvillohet pa prodhim. Ekonomia nuk zhvillohet pa reforma. Ekonomia nuk zhvillohet kur buxheti i shtetit shpenzohet për të blerë vota”, thotë ajo. Bajrami ka pohuar se “deficitit tregtar ndodh kur një shtet importon më shumë mallra sesa eksporton. Me fjalë të tjera deficit tregtar tregon sa para të qytetarëve po përfundojnë jashtë vendit për shkak të varësisë nga importi”.




## Posta e Kosovës dhe Hellenic Beverage Company zgjerojnë partneritetin në shërbimet postare

PRISHTINË, 26 SHKURT - Posta e Kosovës dhe Hellenic Beverage Company-Kosovo L.L.C. kanë nënshkruar kontratë për ofrimin e shërbimeve postare dhe logjistikës së shpërndarjes

nga shërbimet online. Ky partneritet synon ta rrisë efikasitetin e logjistikës dhe shpërndarjes, duke shfrytëzuar rrjetin dhe infrastrukturën e Postës së Kosovës për shërbime

më të shpejta dhe të besueshme. Marrëveshja pasqyron përkushtimin tonë për inovacion dhe cilësi në shërbimet postare. Posta e

Kosovës do të vazhdojë të sjellë zgjidhje moderne logjistike, duke mbështetur tregtinë elektronike dhe lehtësimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.





# VITTORE CARPACCIO, PIKTORI I VESHJES ARBËRORE!

Nga: Merita TOÇILA  
(fragment nga monografia  
Kostumografia në art)

Po të kërkojmë për veshjen më larg në kohë do të mund të zbulojmë vepra të mrekullueshme të artistëve arbëreshë në etapa të ndryshme të historisë, për të cilët edhe është folur. Por lipset të ndalim në periudhën që i takon rilindjes evropiane ku studiuesi Mikel Prenushi ka veçuar disa emra artistësh të cilët me të drejtë ai i konsideron si "Kontributi shqiptar në Rilindjen evropiane" në librin me të njëjtin titull. Ai shkruan midis të tjerash se "ata krijuan në një kohë kur vendi ynë, pas një qëndrese heroike, po kalonte dramën e madhe të pushtimit osman, kur populli ynë, duke mos duruar robërinë ose kishte marrë malet ose kishte zgjedhur rrugën e vështirë të mërgimit."

Mund të përmendim artistin më të shquar mes tyre, Vittore Carpaccio (Viktor Karpaçi), më tej Marco Basaiti, Matia Pretti, Francesco Albani, Michele da Valona, Andrea Alessi etj. Këta artistë portretizuan tipare të shoqërive ku bënë pjesë, skena realiste ose tematika të komanduara me ndjesitë që u provokonte koha. Por, pak prej tyre kanë përfshirë në tablo kostumin me elemente identitare "a la albanese". Ndoshta Carpaccio është arbëreshi i vetëm në veprat e të cilit (ato që kanë mbetur prej tij) gjenden imazhe të veshjes së fisnikëve arbër.


Si pjesëtar i komunitetit të Shkollës Shqiptare në Venedik

(Scuola degli Albanesi) ai trajtoi tematika nga vendi i origjinës. Fasadat e shkollës shqiptare iu besuan atij për t'i zbukuruar, në të cilat krijoi gjashtë tablo e basorieleve, një ndër më të njohurat është rrethimi i Shkodrës. Prenushi në librin e tij shprehet i keqardhur që atij nuk i njihet prejardhja nga Shqipëria, nuk përcaktohet se familja e tij nga Korça me mbiemër Karpaçi ka emigruar në Venedik dhe se ai ishte ndër më aktivët në komunitetin e Shkollës Shqiptare. Shënimet më të sakta i ka lënë ungji i tij, i cili shërbente si frat (frat Ilario) dhe duket se prej tij ka ardhur informacioni burimor, por origjinën, Prenushi shprehet, e vërteton gjithë jeta dhe veprimtaria artistike e tij.

Studiuesi Giovanni Orsini në "Storia dell'arte" (il quattrocento) e ka radhitur së bashku me gjenitë e pikurës venedikase të rilindjes, Andrea Mantegna, Giovanni Bellini, Gentile Bellini etj.

Një studim mbi jetën e artistit më 1907 shpjegon se Vittore Carpaccio është emri i italianizuar i Vektor Scarpazza a Victor Carpatius, siç shënohet në pikturat e para prej vetë artistit, apo siç e thërrisin në rrethin familjar.

Gjithsesi, epoka në të cilën krijoi Carpaccio ishte epoka e artë e Venedikut për nga fuqia ushtarake dhe ekonomike me shkëlqimin e pallateve, bollëkun e zbukurimeve, luksin dhe komoditetin e jetës së qytetëruar; nëpër rrugë dhe sheshe shëtisnin grupe zonjash të veshura bukur, patricë me rroba të gjata dhe njerëz nga orienti veshur me kostume të larmishme; bëheshin pritje



ceremoniale të princërve dhe ambasadorëve të kombeve të tjera. Sa herë që ndonjë personazh rangu njoftonte ardhjen, pritej nga një delegacion fisnikësh veshur me mëndafsh, të zgjedhur sipas sërës të tyre dhe të mysafirrit. Doemos Carpaccio ishte mësuar me përvojën e përditshme të vezullimit të mëndafshit, të shkëlqimit të purpurit në disa nuanca e të dhjetëra llojeve të veshjeve nga Lindja e Perëndimi dhe prezantoi atë që ai pa. Ndaj me penelin e tij u bë kronisti më i vërtetë i aktiviteteve dhe ngjarjeve në të gjitha fazat; individët në qëndrimet dhe gjestet e tyre të përditshme, dhe disa prej veprave ilustrojnë në mënyrë të përkorë ato ceremoni galante, fama e të cilave mbërriti përmes dokumentimeve të shumta. Mes këtij "teatri figurativ

venecian", siç shpesh e emërtojnë studiuesit veprën e tij, ndalet vështrimi te figura e një fisniku që përsëritet herë i plotë, herë në mënyrë fragmentare në tablonë "Mrekulli në urën Rialto", "Shën Ursula" etj.

Në kënd të majtë të tablosë, si një dëshmitar okular i ngjarjes që po ndodh, shquhet një burrë me një mantel me cohë bizantine me ornamente floreale dhe në kokë një kapele të zezë cilindrike me strehë (janë dy figura, por ai në plan të parë është më i dukshëm). Gjesticulacioni dhe qëndrimi i personazhit ka vetëm rol narrativ. Tekstura e pasur e tekstilit, pozicioni i admirueshëm i figurës për të kuptuar strukturën e veshjes na grish të studiojmë veçantitë e secilit medium-tekstilit, lëkurës, metalit, për të kuptuar përmes modelimit të pëlhurës të panjohurën që na fsheh e kaluara. Nëse arrijmë të kuptojmë mund të zbulojmë kodet e humbura të veshjes arbërore në kapërcyell të shekullit XV. Prezenca e tyre në arenën veneciane, dinjiteti me të cilin qëndrojnë, tregon vendin e privilegjuar që zinin në shoqëri, statusin e qëndrueshëm, mirëqenien dhe komunikimin e natyrshëm me botën përreth.

Të dhënat dokumentare në arkiva dhe botime si dhe ato vizive të kohës konfirmojnë se një veshje e tillë emërtohej model shqiptar ose "albanian". Dhe, po t'i referohemi librit të hershëm të kostumeve nga Cesare Vecellio më 1590, ai e ka dokumentuar si veshje nobilis. Kjo e dhënë dhe të tjera nga burime të ndryshme na nxisin të rindërtojmë imazhin e një fisniku arbëror, të kostumeve e fizionomive të humbura në pluhurin e kohës. Karakteristikat e përgjithshme të saj ishin: manteli i gjatë i hapur përpara dhe i mbyllur me sumbulla të dukshme metalike, një jakë në ngjyrë të errët që ndiqte harkun e qafës nënkuptonte veshjen e dytë, mëngët që zgjateshin deri në fund të shtatit dhe lidhja me kordon/brez pëlhere në mes.

Tekstili me shkëlqim të vakët mëndafshi i dekoruar me floreale i jepte një ngjyrim oriental veshjes për syrin e një romani apo veneciani. Poshtë petkut të sipërm shihet një tunikë me jakë të mbyllur në ngjyra simbolike të shtresave të pasura: blu, e artë ose e gjelbër. Kapelja e zezë përcaktonte në mënyrë të padiskutueshme etninë dhe rangun, si elementi më identifikues për çdo mbartës të saj. Vecellio argumenton se ngjyra e zezë përdorej nga fisnikët dhe në ngjyrë skarlet nga tregtarët. Shpërfaqja e një personazhi të tillë në veprat e Carpaccios na bën të aludojmë për paraqitjen reale të fisnikëve arbër dhe përhapjen që pësoi kostumi i tyre më vonë në Evropë.

Tëksa në tablonë "Martesa e Virgjëreshës" në qendër të skenës piktorike është kompozuar figura e një lideri shpirtëror me një kostum të pangjashëm me ato të trajtuara në tablotë e mëparshme me tabare dhe kyrbasia të lartë (qeleshe) siç e mbante Aleksandri i Madh. Afria që paraqet tekstura, modelimi, struktura në prerje dhe sistemi ornamentik me veshjet historike të arbëreshëve në ishujt e Greqisë ngre pikëpyetje të shumta nëse kjo është veshja arbërore e kohës me tipare etnografike brenda territorit arbëror apo është thjesht një mendim hipotetik që lypet të elaborohet më tej.

Duhet thënë se për shkak të prapambetjes ekonomiko-kulturore dhe të ndodhur në kushtet e pushtimit të hapësirës arbërore, u krijua një boshllëk i madh në informacionin mbi veshjet e përdorura nga arbitrit në periudhën e rilindjes evropiane. Ndaj një studim i mirëfilltë i opusit figurativ të artistit arbëresh Carpaccio, dhe ndonjë arbër tjetër që ka trajtuar figura historike, do të mundësonte një analizë më të përplotësuar rreth ecurisë së kostumit arbëror në periudhën e errësirës historike kur tek ne as mund të flitej për art realist shqiptar.



Piktura Mrekulli në urën Rialto (1497-'98) nga Vittore Carpaccio



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Derrick Wilson përforcon KB Ylli

Fundori amerikan Derrick Wilson është rikthyer në basketbollin e Kosovës, por jo te Sigal Prishtina. Wilsoni është zyrtarizuar te skuadra e Golden Eagle Yllit, me të

cilën ka firmosur për pjesën e mbetur të këtij sezoni. Amerikani që sezonin e shkuar ishte ndër më të dalluarit te Sigal Prishtina, po shihet si përforcim i

madh për skuadrën e Yllit. “Gati për emocion, lojë të fortë dhe fitore me fanellën e Golden Eagle Ylli”, ka shkruar faqja suharekase në “Facebook”. Wilsoni e njeh

mirë kampionatin e Kosovës, në të cilin sezonin e kaluar luajti me një mesatare prej 12 pikëve, 5 kërcimeve dhe 6 asistimeve për ndeshje.



## Llapi dhe Drenica kualifikohen në gjysmëfinale, sot zhvillohen dy ndeshjet e tjera



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Skuadra e Llapit dhe ajo e Drenicës janë kualifikuar në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Llapi këtë sukses e arriti falë fitores në çerekfinale kundër Malishevës me rezultat 1-0. Golin e fitores e shënoi Ardit Tahiri në fund të pjesës së parë pas asistimit të Arbnor Ramadanit. Nga ana tjetër, Malisheva pati rastet e veta për shënim, por nuk arriti të barazojë rezultatin dhe në këtë mënyrë duhet të pajtohet me eliminim nga Kupa. Ndërsa

kualifikimin në gjysmëfinale e ka siguruar edhe skuadra nga Liga e Parë, Drenica. Klubi kuqezi arriti që në stadiumin “Bajram Aliu” ta mposhtë skuadrën e Superligës (Ferizajn 1-0). Golin e vetëm në këtë ndeshje e shënoi Mohamed Ange Fofana pas asistimit të Kreshnik Ukës në pjesën e parë. Mysafirët janë munduar ta barazojnë rezultatin, por nuk ishin të suksesshëm. Drenica, gjithashtu, luajti me një lojtar më pak në fushë nga minuta e 59, pas përjashtimit të Auron Hamitit me karton të kuq. Sot (e enjte) do të mësohen dy

gjysmëfinale të tjera në këtë garë. Derbi i rivalëve të vjetër mes Vëllaznimit dhe Prishtinës do të zhvillohet në Gjakovë. Kuqezinjtë bëjnë gara në Ligën e Parë dhe do të përpiqen të shkaktojnë befasi ndaj kryeqytetasve që kanë synime të mëdha në Kupë, kurse liderja e elitës, Drita, do të përballet me Prishtinën e Re ku pa diskutim që është favorite për ta siguruar gjysmëfinalen. Trofeu i Kupës është mjaft i lakmuar për klubet e Kosovës, pasi fituesi i kësaj gare e siguron pjesëmarrjen në gara evropiane.

### SHKURT

#### Unitedi i shtohet garës për Zhegrovën

Unitedi, 26 shkurt - Manchester Unitedi i është shtuar garës për yllin e Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Edon Zhegrova. Bëhet me dije se klubi anglez po synon transferimin e Zhegrovës në verë pasi sulmuesi i krahut ka paralajmëruar largimin nga Lille në fund të këtij sezoni. Ekipi francez tashmë ka caktuar edhe çmimin për Zhegrovën që është 40 milionë euro. Zhegrova te Manchester Unitedi po shihet si përforcim i duhur për sulmin, por nuk do ta ketë aspak të lehtë transferimin e tij për shkak të konkurrencës së fortë. 25-vjeçari po monitorohet edhe nga Juventus, Napoli, Milani, Roma, Borussia Dortmundi e Leipzig, skuadra që po duan ta transferojnë këtë verë. Zhegrova ka kontratë me Lillen deri në verën e vitit 2026, ndërsa këtë sezon ka shënuar 8 gola dhe ka bërë 2 asistime në 21 paraqitje në të gjitha garat.

#### Trajneri i Spartës: Rrahmani bëri punë shumë të mirë

Sulmuesi i Kosovës, Albion Rrahmani, të martën mbrëma, shënoi gol në fitoren 3-0 të Sparta Pragës ndaj Duklas, në ndeshjen e vlefshme për Kupë të Çekisë. Rrahmani luajti vetëm në pjesën e parë pasi ende po e merr veten pas një lëndimi që kishte. Para ndeshjes ishte caktuar që Rrahmani të luante vetëm në pjesën e parë dhe u zëvendësua nga Ermal Krasniqi. 24-vjeçari i ka katër gola në kampionat dhe dy në kupë. “Ai bëri punë shumë të mirë. Ne e nxorëm pas pjesës së parë, pasi po i japim gradualisht hapësirë pas lëndimit. E kemi ditur para ndeshjes se do të zëvendësohet”, ka thënë trajneri i Spartës, Lars Friis.

#### Atalanta llogarit në Gjimshitin ndaj Venezuelas

Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti, do të jetë gati ta ndihmojë skuadrën e Atalantas në ndeshjen e radhës në Serinë A. Bëhet me dije se Gjimshiti nuk ka pasur ndonjë lëndim pasi në ndeshjen e fundit u largua nga fusha e lojës në pjesën e dytë. Kështu që, tek Atalanta llogaritin në shërbimet e Gjimshitit për duelin që e luajnë të shtunën në shtëpi kundër skuadrës së Venezuelas. Më herët ishte raportuar se Gjimshiti kishte dëmtuar nyjën e këmbës në fitoren 5:0 ndaj Empolit, ndeshje në të cilin kontribuoi me një asistim. Por, është konstatuar se ai kishte vetëm një shqetësim muskolor që tashmë e ka kaluar dhe pritet të jetë startues në fundjavë. 32-vjeçari këtë sezon ka 36 ndeshje të luajtura, ku ka shënuar 2 gola dhe ka bërë po aq asistime.

## Kosova U18 në grup me Nigerinë në IHF Trophy Intercontinental

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Në Prishtinë prej 12 deri më 16 mars organizohet faza ndërkontinentale e kampionatit IHF Trophy. Gara do të zhvillohet për hendbollistët e grupmoshës U18 (Youth) dhe ata të grupmoshës U20 (Junior). Kombëtares fituese do të kualifikohen në Kampionatin Botëror

për grupmoshat përkatëse. Te 18-vjeçarët garon edhe Kombëtarja e Kosovës. Kosova është në Grupin B së bashku me Nigerinë dhe Kaledoninë e Re. Në grupin A janë ShBA-ja, Nikaragua dhe Uzbekistani. Te juniorët në Grupin A janë ShBA-ja, Bullgaria dhe Kaledonia e Ri. Ndërkohë Grupi B

përbëhet nga Ruanda, Nikaragua dhe Uzbekistani. Në IHF Trophy Intercontinental paraqiten kombëtares fituese të garës kontinentale të IHF Trophy. Synimi i Kosovës është triumfi dhe kualifikimi në Botëror, që do të ishte i treti për ekipet kombëtare të hendbollit.





## Ronaldo dhe Princi i Arabisë planifikojnë ta blejnë Valencian

VALENCIA, 26 SHKURT - Futbollisti portugez Cristiano Ronaldo po kërkon ta blejë klubin e La Ligas, Valencia, një nga skuadrat më të njohura spanjolle dhe me histori të pasur. Në këtë proces Ronaldo synon të bashkëpunojë me Princin e Kurorës së Arabisë

Saudite, Mohammed bin Salman. Sulmuesi i Al-Nassr është në kërkim të një partneri për ta blerë Valencian dhe mund të arrijë një marrëveshje me Mohammed bin Salman në këtë drejtim. Princi do ta kontrollojë pjesën financiare të marrëveshjes dhe mund të

bëhet zyrtarisht partneri i Cristianos. Vlen të theksohet se fondacioni i drejtuar nga Mohammed bin Salman aktualisht zotëron edhe klubin anglez Newcastle. Aktualisht, Valencia është në pronësi të biznesmenit nga Singapori, Peter Lim Eng Hock. Ai e bleu

skuadrën në vitin 2014, por vitet e fundit skuadra është përballur me probleme të mëdha me rezultatet e saj sportive. Këtë sezon Valencia është në vendin e 18-të në La Liga pas 25 javëve. Kjo tregon se skuadra është në rrezik të rënies nga kategoria.



## Akil Gjakova e Distiria Krasniqi shpallen më të mirët e vitit 2024 nga KOK-u

PRISHTINË, 26 SHKURT - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) në një ceremoni të veçantë ka shpallur sportistët më të mirë të vitit 2024, por edhe kombëtaret më të mira të meshkujt dhe femrat. Sportisti më i mirë i vitit 2024 u shpall Akil Gjakova nga sporti i xhudos. Ai ishte shumë afër medaljes Lojërat Olimpikë në Paris, por u ndal në luftën për medaljen e bronzit të atje. Ndërsa sportistja më e mirë e vitit të kaluar u shpall xhudistja Distiria Krasniqi e cila fitoi medaljen e argjendtë në Paris duke u bërë kështu sportistja e parë me medalje të dyfishtë olimpikë.

Akil Gjakova, pasi pranoi çmimin, tha se sukseset e tij vijnë për shkak të punës së madhe, derisa çmimin ia dedikoi trajnerit të xhudos, Fatos Tabakut. "Rezultatet e mia nuk janë vetëm rastësisht, por prej punës së madhe dhe prej një shkolle dhe një edukate që ma ka dhënë familja ime me një qëndrueshmëri të madhe... Sonte dua ta falënderoj një person të veçantë. Ai është një person që më ka shtyrë prej kur kam qenë i vogël dhe ai



është Fatos Tabaku", ka theksuar Gjakova. Kurse Distiria Krasniqi ka thënë se tashmë ka filluar të punojë për medaljen e tretë olimpikë të cilën synon ta rrëmbejë në Lojërat Olimpikë Los Angeles në vitin 2028. "Për mua çdo medalje olimpikë e ka vlerën e artë, kështu që është hera e dytë që po marrë medalje olimpikë dhe jam shumë krenare me veten. Për Los Angelosin unë veçse kam filluar garat në fillim të shkurtit kam qenë në Paris, ku ka qenë gara e parë pas Lojërave Olimpikë dhe kam marrë medaljen e bronzit. Po ndihem shumë e motivuar për

ta marrë medaljen e tretë në Lojërat Olimpikë", ka deklaruar Krasniqi. Nga çmimet e tjera të sportet ekipore, kombëtarja më e mirë të femrat u shpall Kombëtarja e Kosovës në Hendboll, ndërsa në kategorinë e meshkujve më e mira u shpall Kombëtarja e Kosovës në futboll. Me çmim special për kontribut të madh për imazhin e Kosovës në kategorinë e meshkujve u nderua futbollisti i kombëtares së Kosovës, Edon Zhegrova, kurse te femrat ky çmim i takoi xhudistes Laura Fazliu, ndërsa trajneri më i mirë i vitit u shpall Driton Kuka nga sporti i xhudos.

## Lakersat mposhtin Dallasin

LOS ANXHELOS, 26 SHKURT - Luka Donçić e bën skuadrën e Mawericksit të pendohet për shkëmbimin e tij me Anthony Davies. Slloveni shkëlqeu në parket ndaj ish-skuadrës së tij, teksa arriti të realizojë një triple double falë 19 pikëve, 15 rebaundeve dhe 12 asistimeve, me Lakersat që mposhtën teksanët me shifrat 107-99. Ndeshje shumë e mirë edhe për Jamesin që arriti të realizojë 27 pikë, ndërsa Davies, megjithëse nuk luajti për shkak të dëmtimit, u prit me ovacione nga ish-publiku i tij në Los Angeles. Fitore të thjeshta edhe për dy kryesueset e konferencës së Lindjes, Clevelandit dhe Bostonit. Cavaliers triumfoi në transfertë me rezultat 82-122 ndaj Orlandos, teksa të pesë titullarët e tyre realizuan mbi 10 pikë, duke qenë përcaktues



në këtë sukses. Ndërkohë kampionët e Celticsit triumfuan me rezultat 101-111 ndaj Torontos, teksa u dallua Browni me 24 pikë dhe Derrick White me 22. Ndeshje e ekuilibruar ishte ajo në mes të Houston Rocketsit dhe Milwaukee Bucksit, e fituar nga teksanët ngushtë me rezultat 100-97, teksa Grreni dhe Senguni bën dallimin në parket për Rocketsin. Sfidë spektakolare ishte ajo në mes

të Memphisit dhe Phoenixit, aty ku për ta përcaktuar fituesin u desh Overtime. Vendësit e Grizzliesit triumfuan me rezultat 151-148 teksa Moranti bëri dallimin në parket falë 29 pikëve dhe 8 asistimeve. Fitore e lehtë edhe për Golden State Warriorsin që fitoi thellë me shifrat 128-92 ndaj Charlotes, sfidë ku "ylli" Steph Curry realizoi 15 pikë, dhuroi 6 asistime dhe mori 4 topa në tabelë.

### REZULTATET

LA Lakers - Dallas	107-99
Golden State - Charlotte	128-92
Toronto - Boston	101-111
Orlando - Cleveland	82-122
Houston - Milwaukee	100-97
Memphis - Phoenix	151-148
New Orleans - San Antonio	109-103

## Robertsoni: Salahu vjen nga një tjetër botë

Mohamed Salah vjen në një tjetër botë sipas shokut të skuadrës Andrew Robertson, i cili vlerësoi sulmuesin, pasi egjiptiani shënoi golin e 30 këtë sezon në një fitore

bindëse për Liverpoolin ndaj kampionëve të Manchester Cityt. Mbrojtësi skocez, i cili ishte me Salahun në skuadër kur ata fituan Premierë Ligën e tyre të parë më

2020, ka thënë për egjiptianin: "Ai është në një botë tjetër tani dhe luan jashtë lëkurës së tij. Jemi shumë të lumtur që e kemi, kjo është e sigurt. Ai ka qenë i

pabesueshëm. Një skemë funksionoi te goli, gjë që është e këndshme. Të gjithë patën një rol për të luajtur atje dhe Mo mori lavdinë e vendosjes së topit në

rrjetë. Një tjetër gol dhe asistim. Shkalla e punës së tij ishte e pabesueshme. Ai dhe Diaz ishin çelësi që ne ta ruanim portën e pastër".

### SHKURT

#### Flick pas barazimit ndaj Atletico: Jam i zhgënjyer

Barcelona dhe Atletico Madridi barazuan 4-4 në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Kupës së Mbretit. Trajneri i Barcelonës, Hansi Flick, ka thënë se është i zhgënjyer me golat e pranuar, por edhe i lumtur me luftën që kanë treguar futbollistët e tij. "Jam i zhgënjyer për golat që pësua, sepse ishin shumë të lehtë. Megjithatë, jam i kënaqur me mënyrën se si reagojnë lojtarët dhe me sulmin tonë. Shënuam katër gola, gjë që tregon cilësitë tona ofensive", ka thënë Flick. "Mënyra se si u kthyem në lojë dhe mënyra se si dominuam në disa momente ishte e mrekullueshme. Kjo tregon se kemi një ekip me shpirt luftarak. Ne do të luftojmë deri në fund dhe nuk do të dorëzohemi kurrë. Besoj se kemi një shans të mirë për të fituar në ndeshjen e ardhshme", ka deklaruar Flick.

#### Mourinho rrezikon 10 ndeshje pezullim

Tensionet mbeten të larta pas derbit Galatasaray - Fenerbahçe, me komentet e Jose Mourinhos për Okan Buruk dhe stolin e Galatasarayt që ndezën polemika. Trajneri i Fenerbahçes deklaroi: "Të gjithë në stolin kundërshtar po kërcenin si majmunët", duke shkaktuar reagime të forta nga Galatasaray. Në një deklaratë zyrtare, klubi akuzoi Mourinhon për "vërejtje çnjerëzore dhe imorale", duke njoftuar planet për të paraqitur një ankesë ligjore dhe për ta raportuar atë në UEFA dhe FIFA. Anëtari i bordit të Galatasarayt, Abdullah Kavukcu, i dënoi komentet, duke i quajtur "racizëm të plotë" dhe duke i kërkuar Federatës Turke të Futbollit (TFF) të marrë masa. Polemika ka tërhequr vëmendjen në të gjithë Evropën, me mediet në Angli, Spanjë, Itali, Gjermani dhe Francë, duke etiketuar fjalët e Mourinhos si raciste. Rregulloret e UEFA-s i klasifikojnë komentet e tilla si racizëm, me një pezullim minimal prej 10 ndeshjesh.

#### Amorim rrezikon shkarkimin, Unitedi mendon për Xavin

Manchester Unitedi po kalon një tjetër sezon për t'u harruar. Nuk ka pasur efekt as largimi i Ten Hagut dhe ulja në stol e Ruben Amorim, por është e qartë se në këtë formë nuk mund të vazhdoet pafundësisht pasi Unitedi vijon rënien e lirë. Në këto kushte, sipas medieve, drejtuesit e klubit po mendojnë për një tjetër ndryshim. Nëse Amorim nuk e përmbys shpejt situatën nuk është një çudi që në krye të Unitedit të ulet një tjetër trajner. Sipas Relevo, Xavi Hernandez është opsioni i parë në rast largimi të Amorim. Ish-mesfushori, pas përvojës te Barcelona, mund të tentojë të nisë një aventurë tek Unitedi.

#### Simeone: Lojtarët e mi janë gladiatorë të vërtetë

Atletico Madridi arriti ta barazojë rezultatin ndaj Barcelonës në minutat shtesë në gjysmëfinale të Kupës (4-4). Pas ndeshjes trajneri Diego Simeone vuri theksin te shpirti i ekipit të tij. "Ajo që bie në sy është shpirti i këtij ekipi. Lojtarët e mi janë gladiatorë të vërtetë, kanë një shpirt të jashtëzakonshëm. Kur ndeshja shkoi 4-2 dukej e vështirë për t'u kthyer, por guximi i lojtarëve ishte i pabesueshëm. Festa te goli i katërt? Ishte një shpërthim gëzimi", u shpreh Simeone.



## Drejtoria e Shmlm "Luciano Motroni" në Prizren

Nr. i prot: 147 Dt: 25.02.2025

Mbështetur ne nenin 11, të Udhëzimit Administrativ-Aktivitetet jashtëkurrikulare Nr.02/2016 dhe në vendimin nr.prot: te datës: 13.02.2025, te KDSH-së Shmlm "Luciano Motroni" në Prizren, shpall:

## FTESË PËR OFERTË

## PËR EKSURSION TE MATURANTËVE TË SHMLM "LUCIANO MOTRONI" NË PRIZREN

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agresionet turistike organizatore te udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të SH.M.L.M "Luciano Motroni" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë me datë 02.05.2025 deri më 06.05.2025

Paraqitësit në tender duhet ti plotësojnë këto kritere:

- 1.Certifikatën e biznesit me informatë për biznesin.
- 2.Vërtetimin për pagesën e taksave komunale për vitin 2024 ne origjinale.
- 3.Vërtetimin e Administratës tatimore që nuk ka borgje për vitin 2024 ne origjinale.
- 4.Licencen e transportit ndërkombëtar „D,,
- 5.Referencat rreth organizimit te ekskursioneve me maturantë për tri vitet e fundit: 2022, 2023, 2024
- 6.Fotokopjet e librezave te autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli Teknik.
- 7.Kopjen e sigurimit te autobusëve, patentë shoferë të vozitësve dhe licencat CPC të vozitësve.
- 8.Autobusët të jenë komfor me klimë dhe në numër te mjaftueshëm për mbi 450 vende.
- 9.Certifikatat mjekësore për vozitësit.
- 10.Kompania te sigurojë mjekun (Certifikate pune dhe diplome te mjekut)
- 11.Dëshmi për Hotelin e ofruar në Durrës (Konfirmim rezervimi)
- 12.Të prezantohet ambienti (Komoditeti) së paku me foto i Hotelit, nr. i tel. te pronarit dhe adresa.
- 13.Hoteli të posedoj mbi 450 shtretër.
- 14.Sistemimi i nxënësve ne dhoma te jetë jo me shumë se 4 nxënës.
- 15.Të prezantohet menyja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për 5 ditë qëndrimi.
- 16.Të prezantohet Licencën e agjencionit të akreditimeve ushqimore ne vendqëndrimin e nxënësve.
- 17.Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa e hyrjes sipas itinerarit te përcaktuar nga KDSH-ja
- 18.Hoteli te posedoj sallë për argëtim për nxënës dhe të mos shërbehen dhe lejohen pijet alkoolike.
- 19.Oferta për nxënës të liruar nga pagesa.
- 20.Agjensioni te ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit se paku 200.000 euro.

Vërejtje: Kompania turistike fituese në përfundim të ekskursionit duhet të sigurojë nënshkrimet nga: Drejtori i shkollës, Kryetari i KDSH-se, kryetares se Këshillit të nxënësve, për përmbushjen e kushteve te përcaktuara sipas kriterëve te lartcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

Ofertuesit e interesuar aplikacionin dhe itinerarin e udhëtimit mundë ti marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit ne Prizren.

Afati i paraqitjes në Tender është 7 ditë pune, nga dita e publikimit në gazetë.

Hapja e ofertave bëhet nga Komisioni sipas UA 02/2016 me datën: 05.03.2025 në ora: 16:00 (DKA) Prizren ku mundë të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i paraparë sipas UA do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga Kompanitë, ku do te bëhet vlerësimi i tyre. Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjensionet turistike që i kanë të kompletuar ofertat, kanë numër të mjaftueshëm autobusësh.

Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania turistike e përgjegjshme me çmimin më të ulët te ofertës. Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "NNK" SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810045907 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "NNK" D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810045907 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "NNK" L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 810045907 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Casagrande CG" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811296103 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Casagrande CG" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811296103 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Casagrande CG" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811296103 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "NNK" SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810045907 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "NNK" D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810045907 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "NNK" L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 810045907 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 


[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

SWISS  
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

-Shkolla Fillore dhe e Mesme "Zenit" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70574632.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

